



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1702/21 prot.

Datë 29.10.2025

V E N D I M
Nr. 1555 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 29.10.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1428/2025, datë 10.10.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Nr. REF-48143-05-19-2025, me objekt: Materiale Pastrimi me fond limit 3,282,465 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Besim Kamberi” P.F, me NIPT L42103023G. Adresa: Rruga “Qelqit”, Z. Kadastrale Nr.3866, Nr. Pasurie 310/20 Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gjirokastrë
Adresa: Sheshi “Çerçiz Topulli”, Gjirokastrë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “MURATI D” SHPK, me NIPT K42003004T Adresa: “Rruga e Kavajës”, Ish-Kombinati Ushqimor, godinë 1- katëshe, Tiranë.

Operatori ekonomik “SOFIA MYFTARI” P.F, me Nipt K42611766Q, Adresa: Lagjja “18 Shtatori”, godinë 1 kat, pranë Fakultetit Ekonomik, Gjirokastrë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 10.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1428/2025, ku vendosi:

- 1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” P.F në lidhje me pretendimet për operatorin ekonomik “Murati D” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Nr. REF-48143-05-19-2025, me objekt: “Materiale Pastrimi” me fond limit 3,282,465 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.*
- 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” P.F në lidhje me pretendimet për operatorin ekonomik “Sofia Myftari” P.F në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Nr. REF-48143-05-19-2025, me objekt: “Materiale Pastrimi” me fond limit 3,282,465 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.*
- 3. Autoriteti kontraktor të kthejë për rivlerësim procedurën e prokurimit në lidhje me vlerësimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sofia Myftari” P.F.*
- 4. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi vlerësimin operatorit ekonomik “Sofia Myftari” P.F duke e skualifikuar atë.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” P.F.*
- 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.*
- 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me me shërbim postar me Nr.10792 datë 20.10.2025 protokolluar me tonën me nr. 1702/18, datë 22.10.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 1428/2025 datë 10.10.2025 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën ardhur me me shërbim postar me Nr.10792 datë 20.10.2025 protokolluar me tonën me nr. 1702/18, datë 22.10.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 1428/2025 datë 10.10.2025 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

Referuar shkresës sipërcituar nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor më datë 16.10.2025 ka kryer rivlerësim të ofertave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në zbatim të vendimit të KPP-së.

II.3. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, *Bashkia Gjirokastrë*. ka zbatuar vendimin Nr. 1428/2025 datë 10.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, Nr. REF-48143-05-19-2025, me objekt: “*Materiale Pastrimi*” me fond limit 3,282,465 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.06.2025 nga autoriteti kontraktor, *Bashkia Gjirokastrë*.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, Nr. REF-48143-05-19-2025, me objekt: “*Materiale Pastrimi*” me fond limit 3,282,465 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.06.2025 nga autoriteti kontraktor, *Bashkia Gjirokastrë*.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

